

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"Fenomen " shpk**

Ne Tirane, sot me date 18.08.2022, u paraqitën personalisht ortaket themelues si më poshtë:

1. **Z. Denaldi Dervishi** , shtetas shqiptar, lindur me 28.06.1989, ne Pogradec dhe banues ne Pogradec, identifikuar nepermjet Kartes se Identitetit me Nr. personal **I90628086D**, madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar.
2. **Z.Florenc Bakerri** shtetas shqiptar, lindur me 22.08.1982, ne Bargullas dhe banues ne Tirane, identifikuar nepermjet Kartes se Identitetit me Nr. personal **I20822005A**, madhor, me zotesi te plote juridike e per te vepruar.

Te cilet hartojne kete Akt Themelimi te shoqerise "**FENOMEN** " **SHPK**, mbeshtetur ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, si me poshte:

**KREU 1**

**Neni 1**

**Krijimi**

Shoqeria "**FENOMEN**" **SHPK**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

**Neni 2**

**Personaliteti juridik**

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.



Shoqëria "**FENOMEN**" *shpk*, eshte nje shoqeri, që themelohet ndërmjet ortakeve që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqeria e ka seline ne Tirane, ne Rrugen " NDRE MJEDA " nr pasurie 3/491,zona kadastrale 8220, Kompleksi Kontakt Pallati Lyra, Nr. apartamenti 13.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si



brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakeve te Shoqerise.

#### Neni 4

##### Objekti i veprimtarise

Objekti i veprimtarise se kesaj shoqerie eshte: Eksport-Import,tregti me shumice e pakice te prodhimeve te ndryshme ushqimore.Tregtimin e produkteve dhe nenprodukteve te qumeshtit si djathrat e llojeve te ndryshme gjalpe, margarine, akullore etj. Tregtimin e produkteve dhe nenprodukteve te mishit si sallamrat e llojrave te ndryshme, mish i konservuar etj. Magazinim dhe grumbullim i produkteve bujqesore. Ndertim dhe Rikonstruksione. Ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj dhe kompletimi me instalime te nevojshme per to.

#### Neni 5

##### Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise "**Fenomen**" SHPK eshte e pakufizuar.

### KREU II

### KAPITALI

#### Neni 6

##### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10000 lekë (dhjete mije leke).

- a) Ortaku Denaldi Dervishi eshte zoterues i nje kuote me vlere nominale 5000(pese mije). leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar.
- b) Ortaku Florenc Bakerri eshte eshte zoterues i nje kuote me vlere nominale 5000 (pese mije). leke, qe perben 50% te kapitalit themeltar.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

#### Neni 7

##### **Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave**

*Denaldi*

*Florenc*

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

1. a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;  
b) shitblerjes;  
c) trashëgimisë;  
ç) dhurimit;  
d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
3. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
4. Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.
5. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përbën kusht për vlefshmërinë apo regjistrimin e kontratës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit.

### **KREU III** **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**



#### **Neni 8** **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;



- ... e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Kreditimin në çfaredo banke apo institucion financiar kreditor.
  - j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### Neni 9 Administrimi

Shoqeria do të administrohet nga Z. DENALDI DERVISHI sipas statutit dhe ligjit për një periudhë 5 vjeçare me të drejte ripërteritje.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratoren në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratoren shkarkohen nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person jashtë ortakërisë.



#### Neni 10 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm.

Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike



dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve, bankat e te gjitha niveleve etj. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, si perpara Bankave te te gjitha nivele, per te kryer derdhje, terheqje, transferta, etj, perpara Zyrave te Tatim Taksave, Zyrave te Qeverisjes Vendore, Zyrave te Punes, Autoriteteve Doganore, etj, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Neni 11  
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12  
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 13  
Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 14  
Dispozita perfundimtare


Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe, u miratua ne parim nen per nen nga Ortaket e shoqerise tregtare "Fenomen" shpk, nenshkruset ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

**ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE " Fenomen " SHPK**

**DENALDI DERVISHI**

**FLORENC BAKERRI**

Denaldi Dervishi



FLORENC BAKERRI  
